

Eventi lançues i N'Altitude Festival

Njoftim për Media

Më datë **28 qershor 2021** mbahet event i lançues i festivalit sportiv në mal, "**N'Altitude Festival**"

A do të donit një aventurë në male?

Atëherë ju jeni gati për N'Altitude Festival!

Festivali do mbahet në datat 1-3 tetor 2021, në rajonin Kelmend të Shqipërisë së veriut, ku do të organizohen aktivitete të ndryshme përmes natyrës, aventurave, muzikës dhe traditës. 2021 do të jetë edicioni i parë i këtij festivali i vendosur në Lëpushë, një nga fshatrat më magjepsës të rajonit që ofron pamje piktoreske dhe shanse për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në natyrë.

N'Altitude Festival ndërthur sporte, lojëra, kulturë, traditë, ushqim, muzikë, argëtim dhe shumë më tepër duke ndjekur një qasje të qëndrueshme dhe të orientuar drejt komunitetit që synon njerëz të të gjitha moshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të zgjedhin midis një sërë aktiviteteve si hiking, mountain biking, climbing, yoga, horse riding, paratrike, lojëra, etj. Festivali synon të kontribuojë drejt turizmit të qëndrueshëm në Shqipërinë e veriut, një rajon i cili njihet nga turistët vendas dhe të huaj për bukurinë e tij unik, natyrën e egër dhe traditat e vjetra. Qëllimi është të mbështesë komunitetin lokal duke gjeneruar të ardhura përmes promovimit të rajonit gjatë ditëve të festivalit dhe lidhjes së tij me operatorët turistikë shqiptarë dhe tregun e turizmit në natyrë për bashkëpunime të mundshme në të ardhmen.

„N'Altitude Festival“ është një iniciativë e GIZ Albania, programit "Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural" dhe Bashkisë së Malësisë së Madhe, zbatohet nga Organizata Citrus në partneritet me operatorë turistikë të cilët janë specializuar në turizmin e aventurës. Festivali organizohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencinë Kombëtare të Turizmit.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

